

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendit Komunal të Prishtinës**

Nr i prokurimit	616-25-2547-1-1-1
Nr i brendshëm	616-25-77-1-1-1

Sa i përket tenderit për: **“163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”-Ritender**

A N K E S Ë

Identifikimi i ankuesit*

AGRO INVEST 1 SH.P.K. e cila identifikohet me NUI: 811034280

Adresa : Mushtishtë, p.n. 23000, Suharekë

Numri Telefonit: +38349111625

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:

Adresa elektronike: agroinvest001@gmail.com

Data e parashtrimit të ankesës: 30 KORRIK 2025.

Nënshkrimi dhe vula:



**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Visar Vehapi

(Emri i avokatit)

Rr. Muharrem Fejza

(Adresa e plotë)

+38344190260 /

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

visar_vehapi@yahoo.com

(Adresa elektronike)

30.06.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- Njoftimi për Kontratë i datës 28/03/2025/;
- Përshkrimi i Punëve për Furnizim;
- Procesverbali i hapjes së tenderit i datës 22/04/2025/;
- Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 10/06/2025/;
- Kërkesa për Rishqyrtim e datës 16/06/2025/;
- Vendimi mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim i datës 18/06/2025/;

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	X				Jo		
----	---	--	--	--	----	--	--

Hapja në mënyre elektronike e ofertave është bere me datën 22.04.2025.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kemi paraqitur Kërkesën për Rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit Kontraktues me datën 16/06/2025/, e të cilën do ta elaborojmë me këtë Ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, Ligjin Nr. 05/L-092 të (LPP), janë:

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 -Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë,

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E
RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion UDHËZUES Nr.
002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR
PROKURIMIN PUBLIK

Paragrafi: 9.2 i Neni 9. Kriteret e dhënies së kontratës

Paragrafi: 10.1 i Nenit 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

**Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik –
(RRUOPP A01), janë:**

Neni 28- Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 41- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

Neni 39 - Sqarimi i Tenderëve,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Autoriteti Kontraktues, me datën 28/03/2025/ e kishte shpallur Njoftimin për Kontratë me numrin e prokurimit 616-25-2547-1-1-1, (Numri i brendshëm i prokurimit 616-25-77-1-1-1), me Titullin e Kontratës: **“163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet”** – Ritender.
2. Në këtë Aktivitet të Prokurimit (procedurë të prokurimit) kishin aplikuar (konkuruar) katër Operator Ekonomik, gjegjësisht Grupe të Operatorëve Ekonomik dhe atë:
 - 1) **GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED – Construction Sh.p.k., IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k. me çmimin e ofertës prej 1,972,300.00 €;**

- 2) **GOE EING COM SH.P.K; MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI A.S. me çmimin e ofertës prej 1,447,500.00 €;**
- 3) **GOE HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K., Harstgrup, me çmimin e ofertës prej 1,777,777.00 €;**
- 4) **GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K., Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K. & Ermal Sylaj B.I. me çmimin e ofertës prej 1,356,900.00 €.**
- 5) Me datën 10/06/2025/ Autoriteti Kontraktues e kishte nxjerrë NJOFTIMIN MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, përmes të cilit e kishte shpallë operator Ekonomik të Përgjegjshëm dhe të Suksesshëm GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED – Construction Sh.p.k., IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k. me çmimin e ofertës prej 1,972,300.00 €; Ndërsa Grupin e Operatorëve Ekonomik të përshkruar (identifikuar si në pikën 2. Nën pikat 2), 3), dhe 4) i kishte shpallur të pa suksesshëm.
- 6) Kundër Vendimit (Njoftimit) të lartcekur GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K., Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K. & Ermal Sylaj B.I. me datën 15/06/2025/ kishte parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.
- 7) Me datën 18/06/2025/ Autoriteti Kontraktues e kishte nxjerrë VENDIMIN me të cilin e kishte REFUZUAR Kërkesën për Rishqyrtim të GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K. (me përmbajtjen si në dispozitivin e VENDIMIT të lartcekur.

Kundër VENDIMIT të lartcekur parashtrojmë këtë Ankesë.

Papërgjegjshmëria e Operatorit Ekonomik GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED – Construction Sh.p.k., IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k.

8. GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED – Construction Sh.p.k., IMK – Industria Metalike e Kosovës Sh.p.k. është Operatorë Ekonomik i pa përgjegjshëm, prandaj edhe VENDIMI i atakuar me këtë ankesë është i kundërligjshëm si nga pikëpamja e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, ashtu edhe nga pikëpamja e aplikimit të gabuar të dispozitave të ligjit material të cilat dispozita do të përshkruhen me këtë ankesë.
9. Në vijim do ti paraqesim arsyet dhe faktet se përse OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm dhe është dashur të shpallet si i tillë nga Autoriteti Kontraktues.

Pretendimi 1.

10. GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka firmosur “MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit 2024” e siç kërkohet me LEGJISLACIONI SEKONДАР të miratuar 4/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK.

11. Me datë 11.11.2025. "Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.9 dhe nenin 91 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në pajtim me nenin 19.16 dhe 26.15 të Rregullores nr. 002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, KRPP nxjerrë:

- Formularët Standard:
- Deklarata nën Betim për hartuesit e specifikimeve teknike
- MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit 2024
- AK-ka e ka shkelur këtë Legjislacion Sekondar, duke e shpall fitues një GOE që nuk ka përdor versionin standard të miratuar nga KRPP.

Pretendimi 2

12. Bazuar në kërkesën si në FDT: Kapaciteti ekonomik dhe financiar, kërkesa: 1. Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 2,000,000.00 Euro.

13. GOE ka paraqitur Deklaratat vjetore të dorëzuara në ATK vetëm për kompaninë ED Construction SHPK, ndërsa për kompaninë IMK - Industria Metalike E Kosovës SH.P.K. është dorëzuar "Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera" si dhe për kompaninë lidere nuk ka paraqitur fare Deklarata nga ATK edhe pse është kompani e formuar me datë 11.10.2024. Qarkullimi vjetor total I paraqitur me Deklarata Vjetore në ATK është 1,021,927.10 Euro.

Pretendimi 3

14. Sipas kërkesës si në FDT: Kapaciteti teknik dhe profesional, 1. Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi që ka përfunduar me sukses një kontratë të një natyre të ngjashme.

15. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Duhet saktësuar titullin e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit si dhe referenca ose certifikata për kryerje e furnizimeve.

16. GOE i propozuar për kontratë ka paraqitur asnjë lloj liste që saktëson titullin e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit si dhe referenca ose certifikata për kryerje e furnizimeve. GOE në fjale ka paraqitur kontrata të realizuara nga OE Imk- Industria Metalike e Kosoves për blerjen e tubave të çelikut dhe nuk ka ofruar referenca nga shitesi për realizimin me sukses të ketyre kontratave. Për më tepër konsiderojmë se këto kontrata nuk janë të ngjashme me ato që janë kërkuar në Dosje të Tenderit pasi që tubat e çelikut dallojnë nga ata të materialit PE dhe PP që kerkohen në parametrimin e këtij tenderi.

Pretendimi 4

17. Sipas kërkesës si në FDT: Kapaciteti teknik dhe profesional: 2.Operatoret ekonomik duhen të dorëzojnë Autorizim nga prodhuesi apo Distributori të dedikuar për këtë projekt për shitje dhe mirëmbajtje për produktet kryesore me të cilat ofertojnë si dhe garancionin minimum 24 muaj nga prodhuesi për këto produkte. Dëshmia e kërkuar dokumentare:
18. 2.Autorizim nga prodhuesi ose distributori- Origjinal ose kopje. GOE i propozuar për kontratë ka paraqit Autorizimin nga kompania serbe: Solomon Consultants d.o.o. e cila ne asnjë dokument nuk paraqitet si Distributor apo Përfaqësues i firmës: Environment Solutions ApS. Kjo kompani nuk është e paraqitur fare në uebfaqen e kompanisë prodhuese: <https://nofloods.com/contact-us/> Gjithashtu deklarata e garancisë e ofruar nga GOE është e datës 21.04.2023 si dhe Certificate of Warranty nuk ka datë, nuk përfaqëson asnjë kompani prodhuese, nuk ka datë lëshimi. gjithashtu Ky autorizim nuk është dedikuar për këtë projekt për shitje dhe mirëmbajtje për produktet kryesore, por ky Autorizim është i lëshuar para datës së Njoftimit për Kontratë, i lëshuar me 12.02.2025 ndërsa data e Njoftimit për Kontratë është 31.03.2025 (18 ditë para Njoftimit).

Pretendimi 5

19. Ne paramasë është kërkuar që tubat të jenë fleksibil me diametër 115- 130 cm ndërsa ne katalogun e paraqitur nga Operatori i shpallur fitues shihet se tubat janë me diametër prej 140 cm dhe njëkohësisht e kalojnë lartësinë e mbajtjes së ujit të kërkuar në dosje - prej 80 cm. Ne katalogun e ofruar kjo lartësi është 120 cm, tek tubat 100 dhe 200 m kurse te tubat tjerë nuk përmbushet asnjë kriter i kërkuar.
20. Po ashtu në katalog nuk përshkruhet materiali i kërkuar në Dosje të tenderit- PE dhe PP dhe koha e mbushjes të tubit me ujë e cila është parapare të jete deri në 5 ore.
21. Grupi i OE të shpallur fitues nuk ka paraqitur Ventilet lidhës: Të standardit 4” Storz 110A për mbushjen dhe shkarkimin e ujit, siç janë kërkuar në Dosje të Tenderit.

Bazuar në këto 5 pretendime Autoriteti Kontraktues i rekomanduar për kontratë në mënyrë të kundërligjshme është shpallur operator ekonomik i përgjegjshëm ngase nuk i ka përmbushur as minimalisht kërkesat në dosjen e tenderit.

E poashtu Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, përveç faktit se është i pa përgjegjshëm, i njëjti është dashur të shpallet edhe i pa suksesshëm, për faktin se ka qenë ofertuesi me çmimin më të lartë në këtë aktivitet të prokurimit.

GOE AGRO INVEST 1 SH.P.K., Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K. & Ermal Sylaj B.I.

22. Grupi i Operatorëve Ankues, i cekur si më lartë, është Operator Ekonomik i Përgjegjshëm, për faktin se i njëjti i ka plotësuar të gjitha kriteret për të shpallur fitues



- i këtij tenderi, por Autoriteti Kontraktues, e ka eliminuar duke i shkelur në mënyrë drastike dispozitat ligjore, dhe duke e vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.
23. Grupi i Operatorëve Ankues, përveç faktit se është i përgjegjshëm, i njejtë është edhe i suksesshëm (dhe është dashur të shpallet si i tillë), për faktin se i njejtë ka ofertuar me çmimin më të ulët në raport me të gjithë operatorët tjerë konkures dhe atë për çmimin 1,356,900.00 €.
24. Autoriteti Kontraktues, përveç faktit se nuk i ka vlerësuar drejtë, faktikisht dhe juridikisht ofertat e operatorëve konkures e veçanërisht të Ankueses, i njejtë nuk e ka trajtuar në merita dhe nuk i ka shqyrtuar pretendimet e paraqitura nga parashtuesi i kësaj Ankese, pretendime këto të paraqitura me Kërkesën për Rishqyrtim. Si pasojë e mos trajtimit dhe vlerësimit të pretendimeve si në Kërkesën për Rishqyrtim, e ka nxjerrë një VENDIM (Vendimin e apeluar me këtë ankesë), pa kurrfarë arsytimi! E mungesa e arsytimit është shkelje e dispozitave të Konventës dhe kushtetutës e të cilat do të elaborohen me këtë Ankesë.
25. OE Ankues, pretendon në mënyrë të faktuar se AK-ja në mënyrë të kundërligjshme e ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, pasi që OE ankues i kishte plotësuar të gjitha kërkesat e shpallura në Njoftimin për Kontratë dhe në dosjen e tenderit.
26. “Arsyetimi” i Autoritetit Kontraktues me Njoftimin për eliminim e OE Ankues, nuk qëndron faktikisht dhe juridikisht, në vijim do ti paraqesim “arsyetimin” e eliminimit nga ana e AK-së. Në vijim po citojmë:
- *Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër tre (3) në FDT -Katalogu është në gjuhën gjermane dhe nuk përputhet me katalogun në faqen e internetit (uebsite) të prodhuesit ku nuk i plotëson kërkesat e kërkuara.*
 - *Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbush kërkesat sipas kriterit të DT-së ku: Te materialet: përdorë PVC, nuk i përmbush kërkesat e tenderit që kërkojnë materialet PP dhe PE. PVC është i përdorur gjerësisht për barrierat e përmytjeve, por mund të ketë më pak fleksibilitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë në kushte ekstreme, krahasuar me PP dhe PE.*
 - *Lidhjet dhe Ventilet: ofron Storz 55, që është një tjetër mangësi e rëndësishme, pasi kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A, që ka një diametër më të madh dhe është standardi më i përdorur për sisteme të tilla. Kjo mund të shkaktojë vështirësi për t'u lidhur me pajisje të tjera dhe mund të ndikojë në efikasitetin e sistemit.*
 - *Pikat Mbushëse: Nuk janë dhënë detaje të plota për pikat mbushëse, por është e mundur që pikat të lidhen në mënyrë të centralizuar, siç kërkohet, duke siguruar mbushjen e sistemit me ujë në një pikë të vetme.*

- *Gjatësia e Seksioneve: ofron seksione vetëm deri në 20 metra,. Ne DT kërkohet që seksionet të jenë 100 dhe 200 metra të gjata për shkak të përshtatjeve në terrene të ndryshme, stabilitetit, qëndrueshmërisë ndaj presionit.*
- *Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër katër (4) mungon Certifikatës e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore.*
- *Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numër pesë(5) raporti vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet nuk është i vulosur”.*

27. Ky “arsyetim” nuk qëndron faktikisht dhe juridikisht, dhe në lidhje me këtë OE ankues ka paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim, por Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar fare dhe nuk ka dhënë arsyetim për asnjërin pretendim në kërkesë, pra kemi të bëjmë me rast tipik të Vendimit pa arsyetim.

28. Arsyet se pse nuk qëndron ky “arsyetim” janë si në vijim:

29. Katalogu është ne gjuhen gjermane pasi edhe firma qe prodhon tubat është gjermane dhe te njëjtin na kane dhënë fizikisht gjate vizitës tone ne zyrat e tyre ne Zvicër me date 26.03.2025, ku edhe janë zotuar për te na furnizuar me tubat dhe elementet e kërkuar me dimensionet dhe karakteristikat e përshkruara ne Dosje te këtij projekti.

30. OE Ankues i ka përkthyer edhe në gjuhën shqipe disa terme të një faqe të këtij katalogu ku përshkruhen te dhënat e tubave. Sa i përket pretendimit te Autoritetit Kontraktues se ky katalog nuk gjendet ne faqen zyrtare te firmes Beaver, ju njoftojmë se uebsite e tyre është krijuar ne vitin 2002 dhe rrjedhimisht katalogu i publikuar aty është i vjetër. Për me tepër edhe katalogu i Operatorit te shpallur fitues nuk është i njëjtë me atë te paraqitur ne uebsite- in e firmës prodhuese.

Vërejtje: Praktikant e OSHP-së lidhur me përkthimin e dokumenteve, janë konsistente se kur janë përkthyer dokumentat e domosdoshme për të vetëtuar gjendjen faktike nuk është e domosdoshme që të përkthehen pjesët jo esenciale të dokumentit.

Propozim: Meqenëse po pretendohet se ky katalog nuk gjendet në faqen zyrtare të firmës Beaver, ju lutem të caktoni ekspertizë profesionale për të vërtetuar faktin se ky dokument gjendet në faqen zyrtare dhe përmes ekspertizës të vërtetohet se katalogu i publikuar në ueb faqen zyrtare është i vjetër.

31. Tek specifikat e tubave ne katalog shkruan gjatësia e tubave, konkretisht te rubrika Elementlangen (m) dhe siç shihet gjatësia e tyre është prej 5 deri ne 200 metra. OE ankues e ka prezantuar Certifikatat e firmës Beaver Schutzsysteme AG, te lëshuara nga Europaverband Hochwasserschutz e.V. (EVH)- Shoqata Evropiane për Mbrojtjen

nga Përmbytjet e cila dëshmon për cilësinë dhe sigurinë e tubave ne mbrojtje nga përmbytjet.

32. Sa i përket vulës së raportit të vlerësimit për sistemin mobil, e theksojmë se ne kemi paraqitur raportin origjinal të lëshuar nga Ministria e Hungarisë dhe të vulosur, ndërsa përkthimi i tij ne gjuhën angleze është pa vulë sepse atë e kemi përkthyer për t'ia lehtësuar juve. Nëse na kërkohet këto dokumente do ti përkthejmë në gjuhën shqipe nga përkthyesi i licencuar.

Propozim: Me qëllim të sqarimit të plotësimit të kriterëve teknike nga ana e OE Ankues për këtë aktivitet të prokurimit, i propozojmë OSHP-së që të cakton edhe Ekspertizë Teknike, edhe Ekspertizë të Prokurimit, ku Ekspertiza e Prokurimit, mund të mbështetet në Ekspertizën teknike dhe të jap mendimin dhe konstatimin profesional.

33. Me rastin e eliminimit të OE Ankues, duke mos kërkuar sqarim, shihet se AK-ja qartas që ka vepruar në kundërshtim me Rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik 40.13-Duke mos bërë vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit. Ndërsa, duke e ditur që ne si tenderues kemi ofruar ofertën më të mirë sipas kriterëve për dhënien e kontratës, në bazë të Rregullores për prokurim publik, 45.33, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar vlerësimin e ofertës jashtë kriterëve të cilat nuk kanë qenë të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.
34. Ndërsa neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon Autoritetin Kontraktues që të pranojë ofertat, në rast të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Ndërsa duke u bazuar në Nenin 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve pika.2 AK ka mundur që të kërkojë sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit, në mënyrë që të bëhet Ekzaminimi, Vlerësimi ose Krahasimi i tenderëve sipas Ligjit, Udhëzuesëve dhe Rregulloreve. Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11, 59 dhe 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kriterë që kanë mundur të kërkohet sqarim.
35. Me eliminimin e OE Ankues nga ky aktivitet i prokurimit dhe me shpalljen fitues të GOE, AK e ka favorizuar drejtpërdrejt GOE të rekomanduar për kontratë ndërsa na ka diskriminuar dhe na ka dëmtuar neve si OE të përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë Nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

36. Zyrtaret e AK me këtë vendim po tentojnë ta dëmtojnë buxhetin e Komunës në vlerë prej 615,400.00 Euro pasi ka pretenduar për të shpërblyer me kontratë një GOE më të shtrenjtë sesa neve.
37. Me këtë veprim dhe vendimin e apeluar AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.
38. Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin me çmim më të ulët.
39. Për të gjitha këto pretendime AK-ja nuk kishte dhënë përgjigje në arsyetimin e VENDIMIT të apeluar, me çka e bënë vendimin pa arsyetim. Vendimi i pa arsyetuar është i barabartë me mungesën e arsyetimit të vendimit.
40. Mungesa e arsyetimit e bënë VENDIMIN e apeluar të kundërligjshëm , Kundërkushtetues dhe **me shkelje të KEDNJ-së, nenit 6 të Konventës dhe të qëndrimeve të Gjykatës Kushtetuese në Aktgjykimet e saj**, e cila ka qëndrimet si në vijim:

“Bazuar ne praktiken gjyqësore te GJEDNJ-se, garancitë e mishëruara ne nenin 6 te KEDNJ-se përfshijnë detyrimin qe gjykatat te japin arsye te mjaftueshme për vendimet e tyre. (Shih rastin e GJEDNJ-se, H. Kundër Belgjikës, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; gjithashtu për me shume detaje ne lidhje me te drejtën për një vendim te arsyetuar gjyqësor, shih, Udhëzuesin e GJEDNJ-se për nenin 6 te KEDNJ-se te 30 prillit 2020, E drejta për një proces te rregullt (aspekti civil), IV. Kërkesat Procedurale, 7.Arsyetimet e Vendimeve Gjyqësore, paragrafët 369 deri 380 dhe referencat e përdorura aty). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me te vërtetë, dhe për pasoje kontribuon ne një provueshmëri me te madhe te vendimeve (shih, rastin e GJEDNJ-se Magnin kundër Francës, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29). Kjo praktike gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit qe një gjykate ka një liri te caktuar te vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmime, ajo është e detyruar te justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsye përkatëse (shih, rastet e GJEDNJ-se: Suominen kundër Finlandës, cituar me lart, paragrafi 36; Carmel Saliba kundër Maltes, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73,. dhe shih rastin e Gjykatës: KI227/19, parashtrues: N.T. "Spahia Petrol", cituar me lart, paragrafi 46). Përveç; kësaj, vendimet duhet te jene te arsyetuara ne atë mënyrë qe t'u mundësojnë palëve te shfrytëzojnë ne mënyrë efektive cdo te drejte ekzistuese te ankesës (shih: rastin e GJEDNJ-se Hirvisaari kundër Finlandës, cituar me lart, paragrafi 30). Spanjës, cituar me lart, paragrafi 27, dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI 227/19”.

Kërkojmë nga OSHP-ja që lidhur me vlerësimin e kësaj Ankese të mban seancë publike, dhe Ankuesen ta njofton përpara seancës (në afatin ligjorë) në mënyrë që e njejta së

bashku me Avokatët e saj të marrë pjesë në seancë pranë Panelit Shqyrtues të OSHP-së.

Nga arsyet e cekura me larte i propozojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së që të merre këtë:

V E N D I M

APROVOHET Ankesa e GOE AGRO INVEST I SH.P.K., Beaver Schutzsysteme AG; LORD GROUP SH.P.K. & Ermal Sylaj B.I. si e bazuar.

ANULOHET si i Kundërligjshëm faktikisht dhe juridikisht Vendimi i Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës i datës 18/06/2025/. Me titullin e Kontratës: “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet” – Ritender. Me nr. të Prokurimit 616-25-2547-1-1-1, dhe **ANULOHET** si i kundërligjshëm edhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 10/06/2025/. (me të njëjtin numër të prokurimit të cekur si më lartë), dhe lënda kthehet në Rishqyrtim dhe Rivendosje të Autoritetit Kontraktues (në bazë të dispozitave ligjore). Përndryshe nëse nuk merret parasysh kjo Ankese, ne jemi të detyruar t’i drejtohem Gjykatës Komerciale dhe instancave më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Jemi të dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës, shpenzimet e sigurisë së tenderit, dëmit material dhe fitimi i humbur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Njoftimi për Kontratë i datës 28/03/2025/;
2. Përshkrimi i Punëve për Furnizim;
3. Procesverbali i hapjes së tenderit i datës 22/04/2025/;
4. Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 10/06/2025/;
5. Kërkesa për Rishqyrtim e datës 16/06/2025/;
6. Vendimi mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim i datës 18/06/2025/;
7. Katalogun e firmes BEAVER Protection System;
8. Raportin e vlerësimit të sistemit mobil nga Ministria hungareze.
9. Certifikatat e firmes BEAVER Protection System;

